123	<p>Aliaksandr Yauhenavich SHATROU Аляксандр Яўгенавіч ШАТРОЎ</p> <p>Alexander (Alexandr) Evgenievich SHATROV Александр Евгеньевич ШАТРОВ</p>	<p>Biznesmen, Pronar dhe drejtor i LLC Synesis DOB: POB: Ish BRSS (tani, Federata Ruse) Gjinia: Mashkull Shtetësia: Rus, Bjellorus</p>	<p>Në pozitën e tij si drejtues dhe pronar i LLC Synesis, Alexander Shatrov është përgjegjës për vendimin e kompanisë për të furnizuar autoritetet bjelloruse me platformën vëzhguese, Kipod, e cila mund të kërkojë dhe të analizojë kapjet e videove dhe softuerit të njohjes së fytyrave të punëtorëve (face recognition). Ai po kontribuon në shtypjen e shoqërisë civile dhe opozitës demokratike nga aparati shtetëror. Synesis LLC dhe filialet e tij Panoptes përfitojnë nga pjesëmarrja në Sistemin Republikan të Monitorimit të Sigurisë. Kompani të tjera në pronësi apo në bashkëpronësi të Shatrov, si BeBet dhe Synesis Sport, po ashtu kanë përfituar nga kontratat qeveritare. Ai ka bërë deklarime publike në të cilat kritikon ata që kanë protestuar kundër regjimit Lukashenko dhe kanë vënë në perspektivë mungesën e demokracisë në Bjellorusi. Ai përfiton dhe mbështet regjimin e Lukashenkos.</p>
124	<p>Siarhei Siamionavich TSIATSERYN Сяргей Сямёнавіч ЦЯЦЭРЫН</p> <p>Sergei Semionovich TETERIN Сергей Семёнович ТЕТЕРИН</p>	<p>Biznesmen, pronar i BELGLOBALSTART, bashkëpronar i VIBEL, Kryesues i Federatës Bjelloruse të Tenisit. DTL: 07.01.1961 VNDL: Minsk, ish BRSS (tani Bjellorusi) Gjinia: Mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Siarhei Tsiatseryn është një nga biznesmenët kryesorë që veprojnë në Bjellorusi në biznesin e shpërndarjes së pijeve alkoolike (përmes kompanisë "Belglobalstart"), prodhimeve ushqimore dhe mobiljeve. Ai i përket rrethit të ngushtë të Lukashenkos. Në 2019, Belglobalstart i është dhënë mundësia e ndërtimit të një qendre biznesi shumë-funksionale përballë pallatit presidencial në Minsk. Ai është bashkëpronar i kompanisë VIBEL e cila shet reklama në një numër të madh të kanaleve televizive bjelloruse. Është kryesues i Federatës së tenisit të Bjellorusisë dhe ish këshilltar i Lukashenkos për çështje të sportit. Ai ka bërë komente publike duke dënuar sportistët bjelloruse të cilët kanë protestuar kundër regjimit të Lukashenkos, konkretisht duke protestuar kundër dhunës dhe persekutimit të protestuesve paqësorë, gazetarëve, aktivistëve të të drejtave të njeriut. Publikisht ai u ka kërkuar të gjithë sportistëve t'i kthejnë të gjitha paratë që shteti ka investuar për ta. Ai përfiton dhe mbështet regjimin e Lukashenkos.</p>

125	<p>Mikhail Safarbekovich GUTSERIEV</p> <p>Михаил (Михаил) Сафарбекович ГУЦЕРИЕВ</p>	<p>Biznesmen, pronar i kompanive Safmar, Slavkali dhe Slavneft DTL: 09.05.1958 VNDL: Akmolinsk, ish BRSS (tani Kazakistan) Gjinia: Mashkull Shtetësia: Rus</p>	<p>Mikhail Gutseriev është një biznesmen i famshëm rus me biznese në Bjellorosi në sektorët e energjisë e të tjera. Është mik i vjetër i Aliaksandr Lukashenkos dhe falë kësaj lidhje ka krijuar mirëqenie të konsiderueshme dhe influencë në mesin e elitës politike në Bjellorosi. "Safmar", një kompani e kontrolluar nga Gutseriev, është e vetmja firmë ruse e naftës që furnizoi rafineritë bjelloruse gjatë krizës energjetike mes Bjellorosisë dhe Rosisë në fillim të 2020.</p> <p>Gutseriev po ashtu ka mbështetur Lukashenkon në mosmarrëveshjet me Rusinë mbi shpërndarjen e naftës. Gutseriev është pronar i kompanisë "Slavkali", e cila po ndërton në Nezhinsky fabrikën e nxjerrjes dhe përpunimit të klorurit me bazë në Starobinsky dhe depozitën e kripës së kaliumit në afërsi të Lyuban. Investimin e fundit në Bjellorosi është 2 miliardë dollarë. Lukashenko ka premtuar të emërtojë qytetin e Lyuban me emrin Gutserievsk për nder të tij. Biznesi tjetër i tij në Bjellorosi përfshin "Slavneft" stacione karburanti, depozita vaji, hotel. Qendër biznesi dhe një terminal aeroporti në Minsk. Lukashenko i ka dalë në mbrojtje Gutseriev-it pas fillimit të hetimeve penale ndaj tij në Rusi. Lukashenko gjithashtu ka falenderuar Gutseriev-in për kontributet e tij financiare në bamirësi dhe investime miliardësh në Bjellorosi. Raportohet që Gutseriev i ka bërë dhurata luksozë Lukashenkos.</p> <p>Ai gjithashtu ka deklaruar të jetë pronar i një rezidencë e cila në fakt i përket Lukashenkos, duke e mbuluar në këtë formë kur gazetaret kane bërë hetime të aseteve të Lukashenkos. Raportohet që Gutseriev ka marrë pjesë në inaugurimin privat të Lukashenkos më 23 Shtator 2020. Në tetor 2020 Lukashenko dhe Gutseriev u shfaqën të dy në hapjen e një kisha ortodokse të cilën e ka financuar ky i fundit. Sipas raportimeve të mediave, kur punëtorët e mediave shtetërore të Bjelloruse të cilët patën protestuar me greve u pushuan nga puna në Gusht 2020, punëtorë rusë të mediave erdhën në Bjellorosi për t'i zëvendësuar. Ata fluturuar me aeroplanë të Gutseriev-it dhe qëndruar në hotel Minsk Renaissance që i përkiste.</p> <p>Pra, Mikhail Gutseriev po përfiton dhe po mbështet regjimin e Lukashenkos.</p>
126	<p>Aliaksey Ivanavich ALEKSIN Аляксей Іванавіч АЛЕКСІН</p> <p>Alexei Ivanovich OLEKSIN Алексеј Іванавіч ОЛЕКСІН</p>	<p>Biznesmen, Bashkëpronar i Bremino Group. DTL: VNDL: Gjinia: Mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Aliaksei Aleksin është një ndër biznesmenët kryesorë në Bjellorosi, me biznese në sektorët e naftës dhe energjisë, patundshmërive, zhvillimit, logjistikës, duhanit, shitjeve me pakicë, financa etj. Ka lidhje të ngushtë me Aliaksandr Lukashenka dhe djalin e tij dhe ish këshilltarin për Siguri Kombëtare Viktor Lukashenka. Ai është aktiv në lëvizjen e motoristëve, një pasion që e ndan me Viktor Lukashenka. Kompania e tij zotëron prona në "Alexandria 2" (Rajonin Mogilev), të quajtura "rezidencia presidenciale", ku Aliaksandr Lukashenko është vizitor i shpeshtë.</p>

			<p>Është bashkëpronar i "Bremino Group" – iniciues dhe administrator i projektit të zonave të veçanta ekonomike Bremino-Orsha, të themeluara me dekret presidencial të nënshkruar nga Aliksandr Lukashenka. Kompania ka marrë mbështetje shtetërore për zhvillimin e zonës Bremino-Orsh, si dhe një numër të madh avantazhesh financiare e tatimore dhe përfitime të tjera. Aleksin dhe pronarët e tjerë të Bremino Group kanë marrë mbështetje nga Viktor Lukashenka.</p> <p>Kompanive "Inter Tobacco" dhe "Energo-Oil", të cilat i përkasin Aleksin-it dhe anëtarëve të ngushtë të familjes së tij, iu është dhënë privilegj ekskluziv në importimin e duhanit në Bjellorusi, bazuar në dekretin e nënshkruar nga Aliksandr Lukashenko dhe ka marrë mbështetje shtetërore për krijimin e kioskave Tabakierka. Ka qenë i përfshirë në themelimin e kompanisë së parë private ushtarake të aprovuar nga qeveria në Bjellorusi "GardServis" me lidhje të raportuara në aparatit e sigurisë bjellorus.</p> <p>Pra ai po përfiton nga regjimi i Lukashenkos.</p>
127	<p>Aliksandr Mikalaevich ЗАТСАУ Аляксандр Мікалаевіч ЗАЙЦАЎ</p> <p>Alexander (Alexandr) Nikolaevich ZAITSEV Александр Николаевич ЗАЙЦЕВ</p>	<p>Biznesmen, bashkëpronar i Bremino Group dhe Sohra Group DTL: 22.11.1976 ose 22.11.1975 VNDL: Ruzhany, Brest oblast, ish BRSS (tani Bjellorusi) Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Aliksandr Zaitsau është ish asistent i Viktor Lukashenka, djali dhe këshilltari i për Siguri Kombëtare i Aliksandr Lukashenkos. Përmes qasjes në familjen e Lukashenkos, Zaitsau ka siguruar kontrata fitimprurëse për biznesin e tij. Ai është pronar i Sohra Group, së cilës I është dhënë e drejta e eksportimit të produkteve të ndërmarrjeve shtetërore (traktorë, kamionë) në vendet e Golfit dhe vendet afrikane. Ai është po ashtu bashkëpronar i Bremino Group. Kompania ka marrë mbështetje shtetërore për zhvillimin e zonës Bremino-Orsha, si dhe një numër avantazhesh financiare e tatimore si dhe përfitime të tjera. Zaitsau dhe pronarët e tjerë të Bremino Group kanë marrë mbështetje nga Viktor Lukashenka.</p> <p>Pra ai po përfiton dhe mbështet regjimin e Lukashenkos.</p>
128	<p>Ivan Branislavovich MYSLITSKI Іван Браніслававіч МЫСЛІЦКІ</p> <p>Ivan Bronislavovich MYSLITSKIY Іван Броніслававіч МЫСЛІЦКІЙ</p>	<p>Zëvendës Udhëheqës i Parë i Departamentit të Shërbimit Korrektues Penal të Ministrisë së Punëve të Brendshme DTL: 23.10.1976 VNDL: Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Në pozitën e tij si Zëvendës Udhëheqës i Parë i Departamentit të Shërbimit Korrektues Penal të Ministrisë së Punëve të Brendshme që ka autoritet mbi qendrat e mbajtjes, Ivan Myslitski është përgjegjës për trajtimin jo-njerëzor dhe degradues, përfshirë torturën, shkakuar qytetarëve që kanë marrë pjesë në protesta paqësore dhe janë mbajtur në ato qendra menjëherë pas zgjedhjeve presidenciale të 2020, në përputhje me adresimin e Lukashenkos oficerëve të Ministrisë së Brendshme.</p> <p>Në pozitën e tij, ai ngarkohet me përgjegjësi për kushtet e mbajtjes në burgjet bjelloruse, përfshirë</p>

			<p>kategorizimin e të burgosurve në lloje të ndryshme të keqtrajtimit dhe torturës ndaj të cilave të burgosurit kanë qenë subjekt, si abuzime verbale, izolime ndëshkuese, privim nga telefonatat dhe vizitat, gjymtime, rrahje dhe tortura brutale.</p> <p>Pra ai është përgjegjës për shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe për shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>
129	<p>Aleh Mikalaevich, BELIAKOU Алег Мікалаевіч БЕЛЯКОЎ</p> <p>Oleg Nikolaevich BELIAKOV Олег Николаевич БЕЛЯКОВ</p>	<p>Zëvendës Udhëheqës i Departamentit Korrektues Penal në Ministrinë e Punëve të Brendshme DOB: POB: Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Në pozitën e tij si Zëvendës Udhëheqës i Departamentit Korrektues Penal në Ministrinë e Punëve të Brendshme që ka autoritet mbi qendrat e mbajtjes, Aleh Beliakou është përgjegjës për trajtimin jo-njerëzor dhe degradues, përfshirë torturën, shkaktuar qytetarëve që kanë marrë pjesë në protesta paqësore dhe janë mbajtur në ato qendra menjëherë pas zgjedhjeve presidenciale të 2020, në përputhje me adresimin e Lukashenkos oficerëve të Ministrisë së Brendshme.</p> <p>Në pozitën e tij, ai ngarkohet me përgjegjësi për kushtet e mbajtjes në burgjet bjelloruse, përfshirë kategorizimin e të burgosurve në lloje të ndryshme të keqtrajtimit dhe torturës ndaj të cilave të burgosurit kanë qenë subjekt, si abuzime verbale, izolime ndëshkuese, privim nga telefonatat dhe vizitat, gjymtime, rrahje dhe tortura brutale.</p> <p>Pra ai është përgjegjës për shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe për shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>
130	<p>Uladzislau Aliakseevich MANDRYK Уладзіслаў Аляксеевіч МАНДРЫК</p> <p>Vladislav Alekseevich MANDRIK Владислав Алексеевич МАНДРИК</p>	<p>Zëvendës Udhëheqës i Departamentit Korrektues Penal në Ministrinë e Punëve të Brendshme DTL: 04.07.1971 VNDL: ID: 3040771A125PB2; Pasaportë: MP3810311 Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Në pozitën e tij si Zëvendës Udhëheqës i Departamentit Korrektues Penal në Ministrinë e Punëve të Brendshme që ka autoritet mbi qendrat e mbajtjes, Uladzislau Mandryk është përgjegjës për trajtimin jo-njerëzor dhe degradues, përfshirë torturën, shkaktuar qytetarëve që kanë marrë pjesë në protesta paqësore dhe janë mbajtur në ato qendra menjëherë pas zgjedhjeve presidenciale të 2020, në përputhje me adresimin e Lukashenkos oficerëve të Ministrisë së Brendshme.</p> <p>Në pozitën e tij, ai ngarkohet me përgjegjësi për kushtet e mbajtjes në burgjet bjelloruse, përfshirë kategorizimin e të burgosurve në lloje të ndryshme të keqtrajtimit dhe torturës ndaj të cilave të burgosurit kanë qenë subjekt, si abuzime verbale, izolime ndëshkuese, privim nga telefonatat dhe vizitat, gjymtime, rrahje dhe tortura brutale.</p> <p>Pra ai është përgjegjës për shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe për shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>

131	<p>Andrei Mikalaevich DAILIDA Андрэй Мікалаевіч ДАЙЛІДА</p> <p>Andrei Nikolaevich DAILIDA Андрей Николаевич ДАЙЛИДА</p>	<p>Zëvendës Udhëheqës i Departamentit Korrektues Penal në Ministrinë e Punëve të Brendshme DTL: 01.07.1974 VNDL: Pasaportë: KH2133825 Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Në pozitën e tij si Zëvendës Udhëheqës i Departamentit Korrektues Penal në Ministrinë e Punëve të Brendshme që ka autoritet mbi qendrat e mbajtjes, Andrei Dailida është përgjegjës për trajtimin jo-njerëzor dhe degradues, përfshirë torturën, shkaktuar qytetarëve që kanë marrë pjesë në protesta paqësore dhe janë mbajtur në ato qendra menjëherë pas zgjedhjeve presidenciale të 2020, në përputhje me adresimin e Lukashenkos oficerëve të Ministrisë së Brendshme.</p> <p>Në pozitën e tij, ai ngarkohet me përgjegjësi për kushtet e mbajtjes në burgjet bjelloruse, përfshirë kategorizimin e të burgosurve në lloje të ndryshme të keqtrajtimut dhe torturës ndaj të cilave të burgosurit kanë qenë subjekt, si abuzime verbale, izolime ndëshkuese, privim nga telefonatat dhe vizitat, gjymtime, rrahje dhe tortura brutale.</p> <p>Pra ai është përgjegjës për shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe për shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>
132	<p>Aleh Mikalaevich LASHCHYNOUSKI Алег Мікалаевіч ЛАШЧЫНОЎСКИ</p> <p>Oleg Nikolaevich LASHCHINOVSKII Олег Николаевич ЛАЩИНОВСКИЙ</p>	<p>Ish Zëvendës Udhëheqës i Departamentit Korrektues Penal në Ministrinë e Punëve të Brendshme DTL: 12.05.1963 VNDL: Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Në ish pozitën e tij si Zëvendës Udhëheqës i Departamentit Korrektues Penal në Ministrinë e Punëve të Brendshme që ka autoritet mbi qendrat e mbajtjes, Aleh Lashchynouski është përgjegjës për trajtimin jo-njerëzor dhe degradues, përfshirë torturën, shkaktuar qytetarëve që kanë marrë pjesë në protesta paqësore dhe janë mbajtur në ato qendra menjëherë pas zgjedhjeve presidenciale të 2020, në përputhje me adresimin e Lukashenkos oficerëve të Ministrisë së Brendshme.</p> <p>Në pozitën e tij, ai ngarkohet me përgjegjësi për kushtet e mbajtjes në burgjet bjelloruse, përfshirë kategorizimin e të burgosurve në lloje të ndryshme të keqtrajtimut dhe torturës ndaj të cilave të burgosurit kanë qenë subjekt, si abuzime verbale, izolime ndëshkuese, privim nga telefonatat dhe vizitat, gjymtime, rrahje dhe tortura brutale.</p> <p>Pra ai është përgjegjës për shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe për shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>
133	<p>Zhana Uladzimirauna BATURYTSKAIA Жана Уладзіміраўна БАТУРЫЦКАЯ</p> <p>Zhanna Vladimirovna BATURITSKAYA Жанна Владимировна БАТУРИЦКАЯ</p>	<p>Udhëheqëse e Drejtorisë së Zbatimit të Dënimeve në Departamentin e Shërbimit Korrektues Penal të Ministrisë së Punëve të Brendshme DTL: 20.04.1972 VNDL: Gjinia: Femër Shtetësia: Bjelloruse</p>	<p>Në pozicionin e saj si Udhëheqëse e Drejtorisë së Zbatimit të Dënimeve në Departamentin e Shërbimit Korrektues Penal të Ministrisë së Punëve të Brendshme që ka autoritet mbi qendrat e mbajtjes, Zhana Baturitskaia është përgjegjëse për trajtimin jo-njerëzor dhe degradues, përfshirë torturën, shkaktuar qytetarëve që kanë marrë pjesë në protesta paqësore dhe janë mbajtur në ato qendra menjëherë pas zgjedhjeve presidenciale të 2020, në përputhje me adresimin e Lukashenkos oficerëve të Ministrisë së Brendshme.</p>

			<p>Në pozitën e saj, ajo ngarkohet me përgjegjësi për kushtet e mbajtjes në burgjet bjelloruse, përfshirë kategorizimin e të burgosurve në lloje të ndryshme të keqtrajtimit dhe torturës ndaj të cilave të burgosurit kanë qenë subjekt, si abuzime verbale, izolime ndëshkuese, privim nga telefonatat dhe vizitat, gjymtime, rrahje dhe tortura brutale.</p> <p>Pra ajo është përgjegjëse për shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe për shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>
134	<p>Dzmitry Mikalaevich STREBKOU Дзмітрый Мікалаевіч СТРЭБКОЎ</p> <p>Dmitry Nikolaevich STREBKOV Дмитрий Николаевич СТРЕБКОВ</p>	<p>Udhëheqës i Burgut nr. 8 në Zhodino DTL: 19.03.1977 VNDL:</p> <p>Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Në pozitën e tij si Udhëheqës i Burgut nr. 8 në Zhodino, Dzmitry Strebkou është përgjegjës për kushtet e tmerrshme në burg dhe trajtimin jo-njerëzor dhe degradues, përfshirë torturën, shkaktuar qytetarëve që kanë marrë pjesë në protesta paqësore dhe janë mbajtur në ato qendra, përfshirë dhe në qendrat e ndalimit të përkohshëm, menjëherë pas zgjedhjeve presidenciale të 2020.</p> <p>Pra i është përgjegjës për shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe për shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>
135	<p>Yauhen Andreevich SHAPETSKA Яўген Андрэвіч ШАПЕЦЬКА</p> <p>Evgeniy Andreevich SHAPETKO Евгений Андреевич ШАПЕТЬКО</p>	<p>Udhëheqësi i qendrës së izolimit për kundërvajtës në Akrestina DTL: 30.03.1989 VNDL: Minsk, ish BRSS (tani Bjellorusi) Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Në pozitën e tij si Udhëheqësi i Qendrës së Izolimit për Kundërvajtës në Akrestina, Yauhen Shapetska është përgjegjës për kushtet e tmerrshme në qendrën e izolimit dhe trajtimin jo-njerëzor dhe degradues, përfshirë torturën, shkaktuar qytetarëve që kanë marrë pjesë në protesta paqësore dhe janë mbajtur në ato qendra, përfshirë dhe në qendrat e ndalimit të përkohshëm, menjëherë pas zgjedhjeve presidenciale të 2020.</p> <p>Pra i është përgjegjës për shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe për shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>
136	<p>Ihar Ryhoravich KENIUKH Ігар Рыгоравіч КЕНЮХ</p> <p>Igor Grigorevich KENIUKH Ігорь Григорьевич КЕНЮХ</p>	<p>Udhëheqës i Qendrës së Përkohëshme të Ndalimit në Akrestina DTL: 21.01.1980 VNDL: Rajoni Gomel/Oblast, ish BRSS (tani Bjellorusi) Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Në pozitën e tij si Udhëheqës i Qendrës së Përkohëshme të Ndalimit në Akrestina, Ihar Keniukh është përgjegjës për kushtet e tmerrshme dhe për trajtimin jo-njerëzor dhe degradues, përfshirë rrahjet dhe torturën ushtruar ndaj qytetarëve të mbajtur në këtë qendër pas zgjedhjeve presidenciale të 2020.</p> <p>Ai ka ushtruar presion tek stafi mjekësor duke larguar mjekë të cilët simpatizonin protestuesit. Sipas dëshmisë së shumë grave, të përfshira në raportin e Qendrës për Promovimin e të Drejtave të Grave, "Her Rights", trajtimet më çnjerëzore u bënë në qendrën e ndalimit të Akrestinës në Minsk, ku policët OMON ishin mizorë dhe përdorën tortura.</p>

			<p>Pra i është përgjegjës për shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe për shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>
137	<p>Hleb Uladzimiravich DRYL Глеб Уладзіміравіч ДРЬЛЬ</p> <p>Gleb Vladimirovich DRIL Глеб Владимирович ДРИЛЬ</p>	<p>Zëvendës Udhëheqës i Qendrës së Përkohshme të Ndalimit në Akrestina DTL: 12.05.1980 VNDL: Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Në pozitën e tij si Zëvendës Udhëheqës i Qendrës së Përkohshme të Ndalimit në Akrestina, Hleb Dryl është përgjegjës për kushtet e tmerrshme dhe për trajtimin jonjerëzor dhe degradues, përfshirë rrahjet dhe torturën ushtruar ndaj qytetarëve të mbajtur në këtë qendër pas zgjedhjeve presidenciale të 2020. Sipas dëshmitarëve, disa gra të ndaluara në 9-12 Gusht 2020 janë rrahur rëndë në këto qendra ndalimi. Sipas dëshmisë së shumë grave, të përfshira në raportin e Qendrës për Promovimin e të Drejtave të Grave, "Her Rights", trajtimet më çnjerëzore u bënë në qendrën e ndalimit të Akrestinës në Minsk, ku policët OMON ishin mizorë dhe përdorën tortura.</p> <p>Pra i është përgjegjës për shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe për shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>
138	<p>Uladzimir Iosifavich LAPYR Уладзімір Іосіфавіч ЛАПЫР</p> <p>Vladimir Yosifovich LAPYR Владимир Иосифович ЛАПЫРЪ</p>	<p>Zëvendës Udhëheqësi i Qendrës së Përkohshme të Ndalimit në Akrestina DTL: 21.08.1977 VNDL: Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Në pozitën e tij si Zëvendës Udhëheqës i Qendrës së Përkohshme të Ndalimit në Akrestina, Uladzimir Lapyr është përgjegjës për kushtet e tmerrshme dhe për trajtimin jonjerëzor dhe degradues, përfshirë rrahjet dhe torturën ushtruar ndaj qytetarëve të mbajtur në këtë qendër pas zgjedhjeve presidenciale të 2020. Sipas dëshmisë së shumë grave, të përfshira në raportin e Qendrës për Promovimin e të Drejtave të Grave, "Her Rights", trajtimet më çnjerëzore u bënë në qendrën e ndalimit të Akrestinës në Minsk, ku policët OMON ishin mizorë dhe përdorën tortura.</p> <p>Pra i është përgjegjës për shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe për shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>
139	<p>Aliaksandr Uladzimiravich VASILIUК Аляксандр Уладзіміравіч ВАСІЛЮК</p> <p>Alexander (Alexandr) Vladimirovich VASILIUК Аляксандр Владимирович ВАСИЛЮК</p>	<p>Udhëheqës i ekipit hetues të Komitetit Hetimor të Bjellorusisë DTL: 08.05.1975 VNDL: Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Në pozitën e tij si Udhëheqës i ekipit hetues të Komitetit Hetimor të Bjellorusisë, Aliaksandr Vasiliuk është përgjegjës për persekutimet e motivuara politikisht dhe ndalimet, më veçanti ndaj anëtarëve opozitarë të Këshillit Koordinues, përfshirë lideren e opozitës, Mariya Kalesnikava, e cila konsiderohet si e burgosur politike nga organizatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ai është po ashtu përgjegjës për ndalimin e përfaqësuesve të mediave opozitare.</p> <p>Pra, ai është përgjegjës për shtypjen e shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>

140	<p>Yauhen Anatolevich ARKHIREEU Яўген Анатольевіч АРХІРЭЎ</p> <p>Evgeniy Anatolevich ARKHIREEV Евгений Анатольевич АРХИРЕЕВ</p>	<p>Udhëheqës i Departamentit Kryesor të Hetimeve, Zyra Qendrore e Komitetit Hetimor. DTL: 1.07.1977 VNDL: Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Në pozitën e tij si Udhëheqës i Departamentit Kryesor të Hetimeve, Zyra Qendrore e Komitetit Hetimor të Bjellorusisë, Yauhen Arkhireeu është përgjegjës për fillimin e hetimeve në procese penale të motivuara politikisht, në veçanti ndaj anëtarëve të opozitarë të Këshillit Koordinues dhe protestuesve. Hetime të tilla kanë qëllim të frikësojnë protestuesit si dhe të kriminalizojnë pjesëmarrjen në protesta paqësore.</p> <p>Pra, ai është përgjegjës për shtypjen e shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>
141	<p>Aliaksei Iharovich KAURYZHKIN Алексей Игорович КАЎРЫЖКІН</p> <p>Alexey Igorovich KOVRYZHKIN Алексей Игоревич КОВРИЖКИН</p>	<p>Udhëheqës i Ekipit Hetues, Komiteti Hetimor i Bjellorusisë DTL: 03.11.1981 VNDL: Bobruisk, ish BRSS (tani Bjellorusi) Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Në pozitën e tij si Udhëheqës i Ekipit Hetues, Komiteti Hetimor i Bjellorusisë, Aliaksei Kauryzhkin është përgjegjës për persekutime dhe ndalime të motivuara politikisht, në veçanti ndaj anëtarëve të të ekipit të fushatës presidenciale të Viktor Babarikas dhe anëtarëve të Këshillit Koordinues, përfshirë dhe avokatin Maksim Znak, i cili është konsideruar si i burgosur politik nga organizatat për të drejtat e njeriut.</p> <p>Pra, ai është përgjegjës për shtypjen e shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>
142	<p>Aliaksandr Dzmitryevich AHAFONAU Аляксандр Дзмітрыевіч АГАФОНАЎ</p> <p>Alexander (Alexandr) Dmitrievich AGAFONOV Александр Дмитриевич АГАФОНОВ</p>	<p>Zëvendës Udhëheqës i Parë i Ekipit Hetues, Komiteti Hetimor i Bjellorusisë DTL: 13.03.1982 VNDL: Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Në pozitën e tij si Zëvendës Udhëheqës i Parë i Ekipit Hetues, Komiteti Hetimor i Bjellorusisë, Aliaksandr Ahafonau është përgjegjës për persekutim dhe arrestim të motivuar politikisht të kandidatit presidencial Siarhei Tsikhanousky - activist opozitar dhe bashkëshort I kandidatës për presidente Svetlana Tsikhanouskaya, si dhe aktivistëve të tjetër politikë, përfshirë Mikalai Statkevich dhe Dzmitry Kazlou. Siarhei Tsikhanousky, Dzmitry Kazlou, dhe Mikalai Statkevich njihen si të burgosur politikë nga Viasna, organizatë bjelloruse e të drejtave të njeriut.</p> <p>Pra, ai është përgjegjës për shtypjen e shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>
143	<p>Kanstantsin Fiodorovich BYCHAK Канстанцін Фёдаравіч БЫЧАК</p> <p>Konstantin Fedorovich BYCHEK Константин Фёдорович БЫЧЕК</p>	<p>Udhëheqës i Divizionit të KGB Departamenti i Hetimeve DTL: 20.09.1985 VNDL: Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Në pozitën e tij si Udhëheqës I Divizionit të KGB Departamenti I Hetimeve, Kanstantin Bychak ka mbikëqyrur hetimet e motivuara politikisht ndaj kandidatit presidencial Viktor Babarika. Kandidatura e Babarikas është refuzuar nga Komisioni Qendror Zgjedhor. Ky vendim është bazuar në një raport të KGB-së dhe deklarimeve zyrtare në TV të Bychak, i cili e ka fajësuar për shpëlarje parash ndërkohë që hetimet kanë qenë duke vazhduar.</p> <p>Me 26 Tetor 2020 Bychak ka kërcënuar protestuesit paqësorë në një TV qeveritar duke deklaruar se veprimet e tyre do të klasifikohen si akte terroriste.</p>

			Pra, ai është përgjegjës për shtypjen e shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.
144	<p>Andrei Siarheevich БАКАЧ Андрэй Сяргеевіч БАКАЧ</p> <p>Andrei Sergeevich БАКАЧ Андрей Сергеевич БАКАЧ</p>	<p>Udhëheqës i Qarkut Pervomaysky, Departamenti i Policisë në Minsk DTL: 19.11.1983 VNDL: Minsk, ish BRSS (tani Bjellorusi) Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Në pozitën e tij si Udhëheqës i Departamentit të Punëve të Brendshme të Qarkut Administrativ të Pervomaysky (prej Dhjetor 2019), Andrei Bakach është përgjegjës për veprimet e forcave policore të kësaj zone dhe veprimeve të bëra në stacion policor. Përgjatë periudhës së udhëheqjes së tij, protestuesit paqësorë në Minsk ishin subjekt i trajtimeve mizore, çnjerëzore dhe degraduese brenda stacionit policor nën kontrollin e tij.</p> <p>Pra, ai është përgjegjës për shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>
145	<p>Aliaksandr Uladzimiravich, PALULEKH Аляксандр Уладзіміравіч ПАЛУЛЕХ</p> <p>Aleksandr Vladimirovich POLULEKH Аляксандр Владимирович ПОЛУЛЕХ</p>	<p>Udhëheqës i Departamentit të Policisë të Qarkut të Frunzensky në Minsk DTL: 25.06.1979 VNDL: Minsk, ish BRSS (tani Bjellorusi) Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Në pozitën e tij si Udhëheqës i Drejtorisë së Punëve të Brendshme në Administratën e Qarkut të Frunzensky në Minsk, Aliaksandr Palulekh është përgjegjës për shtypjen e udhëhequr nga forcat policore të këtij distrikti kundër protestuesve paqësorë pas zgjedhjeve presidenciale të 2020, përmes keqtrajtimeve dhe torturimit të protestuesve paqësorë të mbajtur në stacionin policor nën kontrollin e tij.</p> <p>Pra, ai është përgjegjës për shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>
146	<p>Aliaksandr Aliksandravich ZAKHVITSEVICH Аляксандр Аляксандравіч ЗАХВІЦЭВІЧ</p> <p>Aleksandr Aleksandrovich ZAKHVITSEVICH Аляксандр Александрович ЗАХВИЦЕВИЧ</p>	<p>Zëvendës Udhëheqës i Departamentit të Policisë së Frunzensky në Minsk DTL: 01.01.1977 VNDL: Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Në pozitën e tij si Zëvendës Udhëheqës i Departamentit të Policisë së Frunzensky në Minsk, Aliaksandr Zakhvitsevich mbikëqyr policinë për siguri publike dhe është përgjegjës për trajtimin çnjerëzor dhe degradues, përfshirë dhe torturimin ushtruar mbi qytetarët e ndaluar në Qarkun Frunzenskiy pas zgjedhjeve presidenciale të 2020 si dhe për goditje të protestuesve paqësorë në këtë qark. Oficerët nën mbikëqyrjen e Zakhvitsevich përdorën torturë kundër të ndaluarve.</p> <p>Pra, ai është përgjegjës për shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>

147	<p>Siarhei Uladzimiravich USHAKOU Сяргей Уладзіміравіч УШАКОЎ</p> <p>Sergei Vladimirovich USHAKOV Сергей Владимирович УШАКОВ</p>	<p>Zëvendës Udhëheqës i Departamentit të Policisë së Frunzensky në Minsk DTL: 22.08.1980 VNDL: Minsk, ish BRSS (tani Bjellorusi) Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Në pozitën e tij si Zëvendës Udhëheqës i Departamentit të Policisë së Frunzensky në Minsk, Siarhei Ushakou është përgjegjës për veprimet e vartësve të tij, veçanërisht për trajtimet çnjerëzore dhe degraduese, përfshirë torturën, ushtruar ndaj qytetarëve të ndaluar në Qarkun e Frunzensky pas zgjedhjeve presidenciale të 2020 si dhe për goditje të protestuesve paqësorë. Oficerët nën mbikqyrjen e Ushakou's përdorën torturë kundër të ndaluarve.</p> <p>Pra, ai është përgjegjës për shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>
148	<p>Siarhei Piatrovich ARTSIOMENKA Сяргей Пятровіч АРЦЬМЕНКА</p> <p>Sergei Petrovich ARTEMENKO / ARTIOMENKO Сергей Петрович АРТЁМЕНКО</p>	<p>Zëvendës Udhëheqës i Policisë së Qarkut të Pervomaisky në Minsk DTL: 26.03.1973 VNDL: Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Në pozitën e tij si Zëvendës Udhëheqës i Policisë së Qarkut të Pervomaisky në Minsk, duke mbikëqyrur policinë e sigurisë publike, Siarhei Artemenko është përgjegjës për veprimet e vartësve të tij, veçanërisht për trajtimet çnjerëzore dhe degraduese, përfshirë torturën, ushtruar ndaj qytetarëve të ndaluar në Departamentin e Policisë së Qarkut Pervomaiskiy në Minsk pas zgjedhjeve presidenciale të 2020 si dhe për goditje të protestuesve paqësorë. Një shembull është keqtrajtimi i Maksim Haroshin, një luleshitës, i arrestuari pasi u dha lule pjesëmarrësve në Marshin e Grave të datës 13 Tetor 2020. Artemenko ka ushtruar dhunë mbi qytetarët për të mos marrë pjesë në demonstrata paqësore.</p> <p>Pra, ai është përgjegjës për shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>
149	<p>Aliaksandr Mikhailavich RYDZETSKI Аляксандр Міхайлавіч РЫДЗЕЦКІ</p> <p>Aleksandr Mikhailovich RIDETSKIY Александр Михайлович РИДЕЦКИЙ</p>	<p>Ish Udhëheqës i Departamentit të Policisë së Qarkut Oktyabrskiy në Minsk, Udhëheqës i Drejtorisë së Sigurisë së Brendshme në Komitetin Shtetëror për Ekzaminim dhe Forenzikë. DTL: 14.08.1978 VNDL: Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Në ish pozitën e tij si Udhëheqës i Departamentit të Policisë së Qarkut Oktyabrskiy në Minsk, Aliandsandr Rydzetski ishte përgjegjës për veprimet e vartësve të tij, veçanërisht për trajtimet çnjerëzore dhe degraduese, përfshirë torturën, ushtruar ndaj qytetarëve të ndaluar pas zgjedhjeve presidenciale të 2020</p> <p>Pra, ai është përgjegjës për shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>
150	<p>Dzmitry Iauhenevich BURDZIUK Дзмітрый Яўгеньевіч БУРДЗЮК</p> <p>Dmitry Evgenevich BURDIUK Дмитрий Евгеньевич БУРДУК</p>	<p>Udhëheqës i Departamentit të Policisë së Qarkut Oktyabrsky, Ish Udhëheqës i Departamentit të Policisë së Qarkut Partizanski në Minsk</p>	<p>Në ish pozitën e tij Udhëheqës i Departamentit të Policisë së Qarkut Partizanski në Minsk, Dzmitry Burdziuk ishte përgjegjës për mbikëqyrjen e rrahjeve dhe torturave të ashpra ndaj protestuesve paqësorë dhe kalimtarëve të rastit në atë qark pas zgjedhjeve presidenciale të 2020.</p> <p>Në Dhjetor 2020 u caktua Udhëheqës i Departamentit të Policisë së Qarkut Oktyabrsky</p>

		DTL: 31.01.1980 VNDL: Rajoni i Brest, ish BRSS (tani Bjellorusi) Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus ID: 3310180C009PB7 Nr. Pasaporte: MP3567896	Pra, ai është përgjegjës për shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.
151	Vital Vitalevich KAPILEVICH Віталь Вітальевіч КАПЛІЕВІЧ  Vitaliy Vitalevich KAPILEVICH Віталій Вітальевіч КАПЛІЕВІЧ	Udhëheqës i Departamentit të Policisë së Qarkut Leninsky në Minsk DTL: 26.11.1988 VNDL: Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus	Në pozitën e tij si Udhëheqës i Departamentit të Policisë së Qarkut Leninsky në Minsk, Vital Kapilevich është përgjegjës për trajtimet çnjerëzore dhe degraduese, përfshirë torturën, ushtruar ndaj qytetarëve të ndaluar në Departamentin e Policisë së Qarkut Leninsky. Të ndaluarve iu është mohuar ndihma mjekësore; ndihmësmjekët e ardhur në departament, përmes frikësimit, janë ndaluar t'i ofrojnë ndihmë mjekësore të ndaluarve. Pra, ai është përgjegjës për shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe shtypje të shoqërisë civile.
152	Kiryl Stanislavovich KISLOU Кірыл Станіслававіч КІСЛОЎ  Stanislavovich KISLOV Станіслававіч КІСЛОВ	Udhëheqës i Departamentit të Policisë së Qarkut Zavodsky në Minsk DTL: 02.01.1979 VNDL: Minsk, ish BRSS (tani Bjellorusi) Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus	Në pozitën e tij si Udhëheqës i Departamentit të Policisë së Qarkut Zavodsky në Minsk, Kiryl Kislov është përgjegjës për trajtimet çnjerëzore dhe degraduese, përfshirë torturën, ushtruar ndaj qytetarëve të ndaluar në këtë stacion policor. Ai është po ashtu përgjegjës për represionet masive ushtruar nga vartësit e tij ndaj protestuesve paqësorë, gazetarëve, aktivistëve të të drejtave të njeriut, punëtorëve, përfaqësuesve të komunitetit akademik dhe kalimtarëve të rastit.  Pra, ai është përgjegjës për shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe shtypje të shoqërisë civile.
153	Siarhei Aliksandravich VAREIKA Сяргей Аляксандравіч ВАРЭЙКА  Sergey Aleksandrovich VAREIKO Сергей Александрович ВАРЕЙКО	Udhëheqës i Departamentit të Policisë së Qarkut të Moskovskinë Minsk, ish zëvendës Udhëheqës i Departamentit të Policisë së Qarkut Zavodsky në Minsk DTL: 01.02.1980 VNDL: Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus	Me 21 Dhjetor 2020 ishte emëruar Udhëheqës i Departamentit të Policisë së Qarkut të Moskovskinë Minsk.  Pra, ai është përgjegjës për shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe shtypje të shoqërisë civile.
154	Siarhei Feliksavich DUBAVIK Сяргей Феліксавіч ДУБАВІК  Sergey Feliksovich DUBOVIK Сергей Феликсович ДУБОВИК	Zëvendës Udhëheqës i Departamentit të Policisë së Qarkut Leninsky DTL: 01.02.1974 VNDL: Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus	Në pozitën e tij si Zëvendës Udhëheqës i Departamentit të Policisë së Qarkut Leninsky, Siarhei Dubavik është përgjegjës për trajtimet çnjerëzore dhe degraduese, përfshirë torturën, ushtruar ndaj qytetarëve të ndaluar në Departamentin e Policisë së Qarkut Leninsky pas zgjedhjeve presidenciale të 2020. Të ndaluarve iu është mohuar ndihma mjekësore;

			<p>ndihmësmjekët e ardhur në departament, përmes frikësimit, janë ndaluar t'i ofrojnë ndihmë mjekësore të ndaluarve.</p> <p>Ai është po ashtu përgjegjës për represionet masive ushtruar nga vartësit e tij ndaj protestuesve paqësorë, gazetarëve, aktivistëve të të drejtave të njeriut, punëtorëve, përfaqësuesve të komunitetit akademik dhe kalimtarëve të rastit.</p> <p>Pra, ai është përgjegjës për shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>
155	<p>Aliaksandr Mechyslavovich ANDRYEUSKI Аляксандр Мечыслававіч АНДРЬЕЎСКИ</p> <p>Alexander (Alexandr) Mechislavovich ANDRIEVSKIИ Александр Мечиславович АНДРИЕВСКИЙ</p>	<p>Zëvendës Udhëheqës i Departamentit të Policisë së Qarkut Frunzensky në Minsk DTL: 29.04.1982 VNDL: Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Në pozitën e tij si Zëvendës Udhëheqës i Departamentit të Policisë së Qarkut Frunzensky në Minsk, Aliaksandr Andryeuski është përgjegjës për trajtimet çnjerëzore dhe degraduese, përfshirë torturën, ushtruar ndaj qytetarëve të ndaluar në Departamentin e Policisë së Qarkut Frunzensky pas zgjedhjeve presidenciale të 2020.</p> <p>Të ndaluarit janë mbajtur të gjunjzuar me kokë poshtë për orë të tëra, janë rrahur dhunshëm dhe janë goditur me elektroskok.</p> <p>Pra, ai është përgjegjës për shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>
156	<p>Vital Mikhailavich MAKRYTSKI Віталь Міхайлавіч МАКРЫЦКІ</p> <p>Vitalii Mikhailavich MAKRYTSKIИ Віталій Михайлович МАКРЫЦКИЙ</p>	<p>Zëvendës Udhëheqës i Departamentit të Policisë së Qarkut Oktyabrsky në Minsk (deri në 17 Dhjetor 2020). Nga 17 Dhjetor 2020 – Udhëheqës i Departamentit të Policisë së Qarkut Partizanski në Minsk DTL: 17.02.1975 VNDL: Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Në ish pozitën e tij si Zëvendës Udhëheqës i Departamentit të Policisë së Qarkut Oktyabrsky në Minsk, Vital Makrytski është përgjegjës për mbikëqyrjen e rrahjeve të ashpra dhe torturës ndaj protestuesve dhe kalimtarëve të ndaluar në këtë stacion policor pas zgjedhjeve presidenciale të 2020.</p> <p>Në dhjetor 2020 është ngritur në detyrë në pozitën e Udhëheqësit të Departamentit të Policisë në Minsk.</p> <p>Pra, ai është përgjegjës për shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>
157	<p>Yauhen Aliakseevich URUBLEUSKI Яўген Аляксеевіч УРУБЛЕЎСКИ</p> <p>Evgenii Alekseevich VRUBLEVSKIИ Евгений Алексеевич ВРУБЛЕВСКИЙ</p>	<p>Rreshter i Lartë Policor i Qendrës së Izolimit të kundërvajtësve në Akrestina DTL: 28.01 1966 VNDL: Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Në pozitën e tij si Rreshter i Lartë Policor i Qendrës së Izolimit të kundërvajtësve në Akrestina, Yauhen Urubleuski është përgjegjës për trajtimet çnjerëzore dhe degraduese, përfshirë torturën, ushtruar ndaj qytetarëve të ndaluar në Qendrën e Ndalimit të Kundërvajtësve. Sipas dëshmitarëve dhe raporteve të mediave ai mori pjesë personalisht në rrahjet brutale të civilëve të ndaluar në Gusht 2020.</p> <p>Ai është përgjegjës për shkelje të të drejtave të njeriut.</p>

158	<p>Mikalai Mikalaevich <b>KARPIANKAU</b> Мікалаі Мікалаевіч <b>КАРПІЯНКОЎ</b></p> <p>Nikolai Nikolaevich <b>KARPENKOV</b> Ніколай Ніколаевіч <b>КАРПЕНКОВ</b></p>	<p>Zëvendësministër i Punëve të Brendshme, Ish Udhëheqës i Departamentit Kryesor për Luftimin e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit në Ministrinë e Punëve të Brendshme. DTL: 06.09.1968 VNDL: Minsk, ish BRSS (tani Bjellorusi) Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Në pozitën e tij si Udhëheqës i Departamentit Kryesor për Luftimin e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Mikalai Karpiankau është përgjegjës për trajtimet çnjerëzore dhe degraduese, përfshirë torturën, ushtruar ndaj qytetarëve që kanë marrë pjesë në protesta paqësore si dhe për arrestimet dhe ndalimet e tyre arbitrare. Dëshmi të shumta, evidenca me foto dhe video tregojnë se grupi nën komandën e tij ka rrahur dhe arsyetuar protestues paqësor dhe I ka kërcënuar me armë zjarri.</p> <p>Me 6 Shtator 2020, Karpiankou është filmuar duke thyer me shkop një derë xhami në një kafe ku ishin fshehur protestuesit paqësor dhe në mënyrë brutale i ka ndaluar ata. Një incizim është publikuar kur ai ka kërkuar nga departamenti i tij të përdorë armë zjarri kundër protestuesve.</p> <p>Pra, ai është përgjegjës për shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>
159	<p>Mikhail Viachaslavovich HRYB Міхаіл Вячаслававіч ГРЫБ</p> <p>Mikhail Viacheslavovich GRIB Міхаіл Вячеславо́вич ГРИБ</p>	<p>Udhëheqës i Departamentit Kryesor të Punëve të Brendshme i Komitetit Ekzekutiv të Qytetit të Minsk. DTL: 29.07.1980 VNDL: Minsk, ish BRSS (tani Bjellorusi) Gjinia: mashkull Shtetësia: Bjellorus</p>	<p>Mikhail Hryb ishte Udhëheqës i Departamentit të Punëve të Brendshme të Komitetit Ekzekutiv në Rajonin e Vitebsk nga Mars 2019 deri në Tetor 2020, më pas është emëruar Udhëheqës i Departamentit Kryesor të Punëve të Brendshme i Komitetit Ekzekutiv të Qytetit të Minsk me titullin Gjeneral Major i milicisë (forcave të policisë).</p> <p>Në këtë kapacitet, ai është përgjegjës për veprimet e forcave të policisë, respektivisht në rajonin e Vitebsk deri në Tetor 2020 dhe në Minsk prej pas Tetorit 2020, përfshirë dhe shtypjen e dhunshme të protestuesve paqësorë dhe shkeljet e të drejtës për grumbullime paqësore dhe lirisë së shprehjes, të kryera nga forcat e policisë në Vitebsk dhe Minsk, pas zgjedhjeve presidenciale të 2020.</p> <p>Pra, ai është përgjegjës për shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>
160	<p>Viktar Genadzevich KHRENIN Віктар Генадзевіч ХРЭНІН</p> <p>Viktor Gennadievich KHRENIN Виктор Геннадиевич ХРЕНИН</p>	<p>Ministër i Mbrojtjes DTL: 01.08.1971 VNDL: Navahrudak/ Novogrudok, ish BRSS (tani Bjellorusi) Gjinia: Mashkull Shtetësia: Bjellorus Grada: Gjeneral Lejtnant Nr. Pas.: KH2594621 ID: 3010871K003PB1</p>	<p>Në pozitën e tij si Ministër i Mbrojtjes i Bjellorusisë nga 20 Janar 2020, Viktar Khrenin është përgjegjës për vendimet e marra nga Komanda e Forcave Ajrore dhe Forcave Ajrore të Mbrojtjes, nën udhëzimet e Lukashenkos, për të dërguar aeroplanin ushtarak për shoqërimin e aterimit të dhunshëm të avionit të pasagjerëve fluturimi FR4978 në aeroportin e Minsk pa arsyetim të mirëfilltë në 23 Maj 2021. Ky vendim i motivuar politikisht kishte qëllim arrestimin dhe ndalimin e gazetarit opozitar Raman Pratasevich dhe Sofia Sapega dhe është një formë e shtypjes ndaj shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>

			<p>Ai ka bërë deklarata të shumta publike duke deklaruar gatishmërinë e përdorimit të ushtrisë kundër protestuesve paqësorë në Gusht 2020 dhe duke krahasuar përdorimin e flamurit historik -bardh-kuq-bardhe të përdorur nga protestuesit me atë të bashkëpunëtorëve nazistë.</p> <p>Pra, ai është përgjegjës për shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe shtypje të shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>
161	<p>Ihar Uladzimiravich HOLUB Ігар Уладзіміравіч ГОЛУБ</p> <p>Igor Vladimirovich GOLUB Игорь Владимирович ГОЛУБ</p>	<p>Komandant i Forcave Ajrore dhe Mbrojtjes Ajrore të Forcave të Armatosura DTL: 19.11.1967 VNDL: Chernigov, Chernigovskaya oblast, ish BRSS (tani Ukraine) Gjinia: Mashkull Shtetësia: Bjellorus Grada: Gjeneral Major Nr.Pas.: KH2187962 ID: 3191167E003PB1</p>	<p>Në pozitën e tij si Komandant i Forcave Ajrore dhe Mbrojtjes Ajrore të Forcave të Armatosura të Republikës së Bjellorusisë, Ihar Holub është përgjegjës për vendimin e marrë nga Komanda e Forcave Ajrore dhe Forcave Ajrore të Mbrojtjes, nën udhëzimet e Lukashenkos, për të dërguar aeroplanin ushtarak për shoqërimin e aterimit të dhunshëm të avionit të pasagjerëve fluturimi FR4978 në aeroportin e Minsk pa arsyetim të mirëfilltë në 23 Maj 2021. Ky vendim i motivuar politikisht kishte qëllim arrestimin dhe ndalimin e gazetarit opozitar Raman Pratasevich dhe Sofia Sapega dhe është një formë e shtypjes ndaj shoqërisë civile dhe opozitës demokratike në Bjellorusi.</p> <p>Pas incidentit, Ihar Holub bëri deklaratë në konferencë për shtyp bashkë me drejtorin e Departamentit të Ministrisë Transportit dhe Aviacionit të Bjellorusisë, Artem Sikorsky, duke arsyetuar veprimet e autoritetit të aviacionit bjellorus.</p> <p>Pra ai është përgjegjës për shtypjen e shoqërisë civile dhe opozitës demokratike si dhe mbështetjen e regjimit të Lukashenkos.</p>
162	<p>Andrei Mikalaevich GURTSEVICH Андрэй Мікалаевіч ГУРЦЕВІЧ</p> <p>Andrei Nikolaevich GURTSEVICH Андрей Николаевич ГУРЦЕВИЧ</p>	<p>Shef i Stafit Kryesor, Zëvendës Komandant i Parë i Forcave Ajrore DTL: 27.07.1971 VNDL: Baranovich, Rajoni Brest / Oblast, ish BRSS (tani Bjellorusi) Gjinia: Mashkull Shtetësia: Bjellorus Grada: Gjeneral Major Nr. Pas: MP3849920 ID: 3270771C016PB2</p>	<p>Në pozitën e tij si Shef i Stafit Kryesor, Zëvendës Komandant i Parë i Forcave Ajrore të Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, Andrei Gurtsevich është përgjegjës për vendimet e marra nga Komanda e Forcave Ajrore dhe Forcave Ajrore të Mbrojtjes, nën udhëzimet e Lukashenkos, për të dërguar aeroplanin ushtarak për shoqërimin e aterimit të dhunshëm të avionit të pasagjerëve fluturimi FR4978 në aeroportin e Minsk pa arsyetim të mirëfilltë në 23 Maj 2021.</p> <p>Ky vendim i motivuar politikisht kishte qëllim arrestimin dhe ndalimin e gazetarit opozitar Raman Pratasevich dhe Sofia Sapega dhe është një formë e shtypjes ndaj shoqërisë civile dhe opozitës demokratike në Bjellorusi. Pas incidentit bëri deklaratë në konferencë për shtyp duke arsyetuar veprimet e autoriteteve bjelloruse.</p> <p>Pra ai është përgjegjës për shtypjen e shoqërisë civile dhe opozitës demokratike si dhe mbështetjen e regjimit të Lukashenkos.</p>

163	<p>Leonid Mikalaevich CHURO Леонід Мікалаевіч ЧУРО</p> <p>Leonid Nikolaevich CHURO Леонід Николаевіч ЧУРО</p>	<p>Drejtor i Përgjithshëm i BELAERONAVIGATSIA Ndërmarrje shtetërore DTL: 08.07.1956 VNDL: Gjinia: Mashkull Shtetësia: Bjellorus Nr. Pas.: P4289481 ID: 3080756A068PB5</p>	<p>Në pozitën e tij si Drejtor i Përgjithshëm i BELAERONAVIGATSIA Ndërmarrje shtetërore, Leonid Churo është përgjegjës për kontrollin e trafikut ajror të Bjellorusisë. Ai pra bart përgjegjësi në devijimin e avionit të pasagjerëve fluturimi FR4978 në aeroportin e Minsk pa arsytim të mirëfilltë në 23 Maj 2021. Ky vendim i motivuar politikisht kishte qëllim arrestimin dhe ndalimin e gazetarit opozitar Raman Pratasevich dhe Sofia Sapega dhe është një formë e shtypjes ndaj shoqërisë civile dhe opozitës demokratike në Bjellorusi.</p> <p>Pra ai është përgjegjës për shtypjen e shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>
164	<p>Aliaksei Mikalaevich AURAMENKA Аляксей Мікалаевіч АЎРАМЕНКА</p> <p>Alexey Nikolaevich AVRAMENKO Алексей Николаевіч АВРАМЕНКО</p>	<p>Ministër i Transportit dhe Komunikacionit DTL: 11.05.1977 VNDL: Minsk, ish BRSS (tani Bjellorusi) Gjinia: Mashkull Shtetësia: Bjellorus Nr. Pas.: MP3102183 ID: 3110577A020PB2</p>	<p>Na pozitën e tij si Ministër i Transportit dhe Komunikacionit i Bjellorusisë, Aliaksei Auramenka është përgjegjës për menaxhimin shtetëror në sferën e aviacionit civil dhe mbikëqyrjen e kontrollit të trafikut ajror. Prandaj ai ka përgjegjësi në devijimin e avionit të pasagjerëve fluturimi FR4978 në aeroportin e Minsk pa arsytim të mirëfilltë në 23 Maj 2021. Ky vendim i motivuar politikisht kishte qëllim arrestimin dhe ndalimin e gazetarit opozitar Raman Pratasevich dhe Sofia Sapega dhe është një formë e shtypjes ndaj shoqërisë civile dhe opozitës demokratike në Bjellorusi.</p> <p>Pra ai është përgjegjës për shtypjen e shoqërisë civile dhe opozitës demokratike.</p>
165	<p>Artsiom Igaravich SIKORSKI Арцём Ігаравіч СІКОРСКІ</p> <p>Artem Igorevich SIKORSKIY Артем Игоревич СИКОРСКИЙ</p>	<p>Drejtor i Departamentit të Aviacionit në Ministrinë e Transportit dhe Komunikacionit. DTL: 1983 VNDL: Soligorsk, Minsk Region/ Oblast, ish BRSS (tani Bjellorusi) Gjinia: Mashkull Shtetësia: Bjellorus Nr. Pas.: MP3785448 ID: 3240483A023PB7</p>	<p>Në kapacitetin e tij si Drejtor i Departamentit të Aviacionit në Ministrinë e Transportit dhe Komunikacionit të Bjellorusisë, Artsiom Sikorski është përgjegjës për menaxhimin shtetëror në sferën e aviacionit civil dhe mbikëqyrjen e kontrollit të trafikut ajror. Prandaj ai ka përgjegjësi në devijimin e avionit të pasagjerëve fluturimi FR4978 në aeroportin e Minsk pa arsytim të mirëfilltë në 23 Maj 2021. Ky vendim i motivuar politikisht kishte qëllim arrestimin dhe ndalimin e gazetarit opozitar Raman Pratasevich dhe Sofia Sapega dhe është një formë e shtypjes ndaj shoqërisë civile dhe opozitës demokratike në Bjellorusi.</p> <p>Pas incidentit dha deklaratë për shtyp bashkë me Komandantin e Forcave Ajrore dhe Forcave Ajrore të Mbrojtjes së Forcave të Armatosura të Bjellorusisë, Ihar Holub, duke justifikuar veprimet e autoriteteve bjelloruse të aviacionit.</p> <p>Pra ai është përgjegjës për shtypjen e shoqërisë civile dhe opozitës demokratike dhe mbështetje të regjimit të Lukashenkos.</p>

166	<p>Aleh Siarheevich HAIDUKEVICH Алег Сяргеевіч ГАЙДУКЕВІЧ</p> <p>Oleg Sergeevich GAIDUKEVICH Олег Сергеевич ГАЙДУКЕВИЧ</p>	<p>Zëvendës Kryesues I Komisionit të Përhershëm për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Shtëpinë e Përfaqësuesve të Asamblesë Kombëtare, Anëtar i delegacionit të Asamblesë Kombëtare për kontakt me Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës. DTL: 26.03.1977 VNDL: Minsk, ish BRSS (tani Bjellorusi) Gjinia: Mashkull Shtetësia: Bjellorus ID: 3260377A081PB9 Nr. Pas.: MP2663333</p>	<p>Aleh Haidukevich ka bërë deklarime publike duke duartrokatur devijimin e avionit të pasagjerëve fluturimi FR4978 në aeroportin e Minsk pa arsytim të mirëfilltë në 23 Maj 2021. Ky vendim i motivuar politikisht kishte qëllim arrestimin dhe ndalimin e gazetarit opozitar Raman Pratasevich dhe Sofia Sapega dhe është një formë e shtypjes ndaj shoqërisë civile dhe opozitës demokratike në Bjellorusi.</p> <p>Për më tepër, Aleh Haidukevich bëri deklarime publike duke sugjeruar që liderët opozitarë bjellorusë mund të ndalohen jashtë dhe të kthehen në Bjellorusi në "Bagash makine", duke mbështetur në këtë mënyrë goditjet e vazhdueshme të forcave bjelloruse të sigurisë ndaj opozitës demokratike dhe gazetarëve.</p> <p>Ai pra, mbështet regjimin e Lukashenkos.</p>
